



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:043731

Datë: 10.12.2024

Numri i dokumentit: 06574050

KE.nr.2381/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të paditësit “The Coca-Cola Company”, me seli në 310 North Avenue N.W.30313 Atlanta, Georgia USA, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Agron Selimaj, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit “Dea IB” SH.P.K., me seli në Gjakovë, me numër unik identifikues 811298274, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Liman Musa, avokat nga Ferizaj, me objekt kontesti shkelje e markës tregtare, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik me datë 04.12.2024, në prezencë të përfaqësuesve të palëve, me datën 10.12.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “The Coca-Cola Company” dhe VËRTETOHET se i padituri “Dea IB” SH.P.K.:
- a. me datën 25.02.2022 me importimin e 10,950 shishe (2 l) të pijes së gazuar joalkoolike “Coca-Cola”, ka shkelur markën e regjistruar tregtare “Coca-Cola” e regjistruar në pronësi të paditësit me numër të regjistrimit 2982;
 - b. me datën 28.02.2022 me importimin e 10,560 shishe (0.33 ml) të pijes së gazuar joalkoolike “Fanta Orange” ka shkelur markën tregtare “Fanta” e regjistruar në pronësi të paditësit me numër të regjistrimit 2980;
 - c. me datën 28.02.2022 me importimin e 50,160 shishe (0.33 ml) të pijes së gazuar joalkoolike “Fanta Exotic” ka shkelur markën tregtare “Fanta” e regjistruar në pronësi të paditësit me numër të regjistrimit 2980;

- d. me datën 28.02.2022 me importimin e 5,280 shishe (0.33 ml) të pijes së gazuar joalkoolike “Sprite” ka shkelur markën tregtare “Sprite” e regjistruar në pronësi të paditësit me numër të regjistrimit 5901;
- II. URDHËROHET shkatërrimi i mallrave të cekura si në pikën I të këtij dispozitivit me shpenzimet e të paditurit, në afat prej shtatë (7) ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- III. OBLIGOHET i padituri që të mbuloj të gjitha shpenzimet e magazinimit të mallrave si në pikën I të dispozitivit, në afat prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- IV. I NDALOHET të paditurit që në të ardhmen të ndërmarrë çfarëdo veprimi me të cilin mund të shkelen të drejtat e pronësisë intelektuale të paditësit, në çfarëdo mënyre, përfshirë importimin, eksportimin dhe vendosjen në treg të produkteve që përbëjnë shkelje të markës tregtare të paditësit.
- V. OBLIGOHET i padituri që me shpenzime të tij ta publikoj këtë aktgjykim në tri medime të Republikës së Kosovës, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- VI. MBETET në fuqi masa e sigurisë e caktuar me aktvendimin IV.EK.nr.128/22 të datës 04.04.2022, deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.
- VII. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit “The Coca-Cola Company” me të cilën ka kërkuar që të:
- a. Urdhërohet Dogana e Kosovës dhe Inspektorati i Tregut që të konfiskon dhe shkatërrojnë të gjitha produktet e ndodhura kundërligjshëm në territorin e Republikës së Kosovës pa autorizim dhe / apo pëlqimin e paditësit dhe bartësit të së drejtës së markës tregtare;
 - b. Urdhërohet i paditurit “Dea IB” SH.P.K. që ti ofroj paditësit në dispozicion Deklaratat Unike Doganore për produktet e importuara pa autorizimin dhe / apo pëlqimin e bartësit të së drejtës së markës tregtare për 3 vitet e fundit duke filluar nga data e nxjerrjes së vendimit gjyqësor dhe
 - c. Detyrohet i padituri “Dea IB” SH.P.K. që paditësit “The Coca-Cola Company” ti kompensoj dëmin material të shkaktuar me veprimet e kundërligjshme dhe të paautorizuara.

VIII. DETYROHET i padituri që paditësit të ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 2,108.00€ (dymijë e njëqind e tetë euro), në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi “The Coca-Cola Company” përmes të autorizuarit të tyre, me datën 04.03.2022, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, kanë paraqitur padi për shkeljen e markës tregtare kundër të paditurit “Dea IB” SH.P.K., duke kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit dhe të vërtetohet se i padituri “Dea IB” SH.P.K., me përdorimin e markës tregtare “Coca-Cola”, “Fanta” dhe “Sprite”, 10,950 shishe (2 ltr) të pijes së gazuar joalkoolike “Coca-Cola”, 0,560 shishe (0.33 ml) të pijes së gazuar joalkoolike “Fanta Orange”, 50,160 shishe (0.33 ml) të pijes së gazuar joalkoolike “Fanta Exotic”, 5,280 shishe (0.33 ml) të pijes së gazuar joalkoolike “Sprite” ka shkelur markat tregtare të paditësit nr. 2982, 2980 dhe 5901 si dhe ka kërkuar që të urdhërohet i padituri që ti tërheq nga tregu dhe ti shkatërroj me shpenzimet e veta të gjitha pijet e gazuara joalkoolike “Cola Cola”, “Fanta” dhe “Sprite” të importuara pa autorizim apo pëlqimin e paditësit; ti ndalohet të paditurit cdo aktivitet që do të shkelte të drejtën e paditësit në markat e regjistruara tregtare, në vecanti importimi, eksportimi dhe vendosja në tregun e Kosovës të produkteve që përbëjnë shkleje të markës tregtare të paditësit; të urdhërohet shkatërrimi i mallrave të importuara pa autorizimin e bartësit të drejtës së markës tregtare dispozitivit me shpenzimet e të paditurit; të obligohet i padituri që të mbuloj të gjitha shpenzimet e magazinimit të mallrave; të obligohet i padituri që me shpenzime të tij ta publikoj këtë aktgjykim në tri medime të Republikës së Kosovës si dhe të urdhërohet Dogana e Kosovës dhe Inspektorati i Tregut që të konfiskon dhe shkatërron të gjitha produktet e ndodhura kundërligjshëm në territorin e Republikës së Kosovës pa autorizim dhe / apo pëlqimin e paditësit dhe bartësit të së drejtës së markës tregtare; urdhërohet i paditurit “Dea IB” SH.P.K. që ti ofroj paditësit në dispozicion Deklaratat Unike Doganore për produktet e importuara pa autorizimin dhe / apo pëlqimin e bartësit të së drejtës së markës tregtare për 3 vitet e fundit duke filluar nga data e nxjerrjes së vendimit gjyqësor dhe detyrohet i padituri “Dea IB” SH.P.K. që paditësit “The Coca-Cola Company” ti kompensoj dëmin material të shkaktuar me veprimet e kundërligjshme dhe të paautorizuara, po ashtu ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore.

Në referatin e padisë ka theksuar që me datën 25.02.2022 dhe 28.02.2022 janë njoftuar nga Dogana e Kosovës, se është pezulluar lirimi i mallrave kontestuese të paditurit, për shkak të dyshimit se të njëjtat shkelin markat tregtare të paditësit duke theksuar që paditësit i kanë të

mbrojtura markat tregtare sipas vendimeve nr. KS/2021/6110 “Coca-Cola”, nr. KS/2021/5875 “Fanta” dhe nr. 5901-1/2013 “Sprite”. Ka shtuar se paditësit me marrëveshjen e datës 27.07.2009 autorizon ekskluzivisht shoqërinë tregtare kosovare “Coca Cola Hellenic Bottling Company – Kosovo” L.L.C., të furnizon dhe paketon, të distribuon / shpërndan dhe të shet të gjitha produktet sipas markës tregtare të regjistruar të paditësit për territorin e Republikës së Kosovës.

Gjykatës i ka propozuar që të nxjerrët provat përmes ekspertizë financiare me qëllim të përcaktimit të dëmit material dhe fitimit të humbur të shkaktuar paditësit si dhe përcaktimin e fitimin e humbur që do të mund ta realizonte paditësi po që se i padituri nuk do të importonte produktet e paditësit në datat e lartcekura dhe tre vitet e fundit, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në bazë të provave është vërtetuar se i padituri me datë 25 dhe 28 shkurt 2022 ka provuar që në mënyrë të kundërligjshme të importoj produktet e paditësit në Kosovë pa autorizim dhe pëlqimin e paditësit, bartësit të së drejtës të regjistruar të markës tregtare. Me këto veprime i padituri ka shkelur legjislacionin relevant për mbrojtjen e markave tregtare. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

I padituri gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke u bazuar në faktin se mallrat janë importuar nga një degë apo përfaqësuesi e autorizuar e vet përfaqësuesit të markës tregtare e që në realitet kemi të bëjmë me import paralel konform rekomandimeve të BE-së ku mallrat paralele duhet të trajtohen si mallra origjinale dhe se kemi të bëjmë me mall origjinal të prodhuar nga një degë apo nën përfaqësi e autorizuar, në rastin konkret konform rregullave dhe rekomandimeve të BE-së, të cilat Kosova është e obliguar t’i zbatoj. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet padia e paditësit si e pabazuar, ndërsa shpenzimet e procedurës i ka kërkuar konform TOAK-së.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore dhe në bazë të propozimeve të palëve ndërgjyqëse, gjykata në rigjykim gjatë procedurës së provave bëri administrimin e këtyre provave: Marrëveshje mbi mbushjen e shisheve datës 27.07.2009; Vendim për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare nr. 2982 e datës 28.10.2021; Vendim për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare nr. 2980 e datës 07.10.2021; Vendim për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare nr. 5901 e datës 28.02.2013; Të dhënat nga ARB për të paditurin; Njoftim nga Dogana e Kosovës- Rasti 83-2022 Coca-Cola; Njoftim nga Dogana e Kosovës- Rasti 84-2022 Coca-Cola; Komunikim elektronik i datës 09.11.2020, 10.11.2020; Shkresë me titull “Sqarim lidhur me importin paralel përcaktuar me nenin 12 të LMT” i datës 03.03.2022.

Gjykata pas vlerësimit të deklarimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka konstatuar këtë gjendje faktike.

Nga Vendim për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare nr. 2982 e datës 28.10.2021 gjykata konstatoi se paditësi ka vazhduar regjistrimin e markës tregtare “Coca-Cola” në klasat 30 dhe 32, me vlefshmëri deri me datë 01.10.2031.

Nga Vendim për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare nr. 2980 e datës 07.10.2021 gjykata konstatoi se paditësi ka vazhduar regjistrimin e markës tregtare “Fanta” në klasat 30 dhe 32, me vlefshmëri deri me datë 01.10.2031.

Nga Vendim për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare nr. 5901 e datës 28.02.2013 gjykata konstatoi se paditësi ka vazhduar regjistrimin e markës tregtare “Sprite” në klasën 32, me vlefshmëri deri me datë 020.02.2023

Nga Njoftim nga Dogana e Kosovës- Rasti 83-2022 Coca-Cola, gjykata konstatoi se Dogana e Kosovës me datë 25.02.2022 ka njoftuar paditësin se ka pezulluar lirimin e mallrave të dyshuara për shkeljen e të drejtave të pronësisë intelektuale për të cilat është aprovuar kërkesa për veprim nga Dogana e Kosovës ashtu që ka njoftuar se ka ndaluar pije freskuese – Coca-Cola pet 2 ltr në sasi 1825 pako 6 x 2 ltr apo 10,950 shishe 2 litra.

Nga Njoftim nga Dogana e Kosovës- Rasti 84-2022 Coca-Cola, gjykata konstatoi se Dogana e Kosovës me datë 28.02.2022 ka njoftuar paditësin se ka pezulluar lirimin e mallrave të dyshuara për shkeljen e të drejtave të pronësisë intelektuale për të cilat është aprovuar kërkesa për veprim nga Dogana e Kosovës ashtu që ka njoftuar se ka ndaluar pije freskuese – Fanta organe can 0.33/440 pako x 24 copë – 10,560 copë; fanta exotic can 0.33/2090 pako x 24 copë – 50,160 copë dhe Sprite can 0.33/220 pako x 24 copë – 5,280 copë.

Nga Komunikim elektronik i datës 09.11.2020, 10.11.2020 dhe Shkresë me titull “Sqarim lidhur me importin paralel përcaktuar me nenin 12 të LMT” i datës 03.03.2022, gjykata konstatoi se të njëjtat komunikime nuk kanë të bëjnë me rastet konkretet që janë objekt i shqyrtimit sipas kërkesëpadisë së paditësit.

Gjykata pas shqyrtimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, sepse i padituri ka futur në tregun e Kosovës

mallra pa lejen e bartësit të së drejtës së markës tregtare e drejtë kjo e cila ka vlejtur derisa ka qenë në fuqi Ligjit nr. 04/L-026 për Markat Tregtare (LMT) ndërsa gjykata refuzoi pjesën tjetër të kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit dhe kërkesat që tejkalojnë rastet e identifikuara nga Dogana e Kosovës të datës 25.02.2022 dhe 28.02.2022.

Sipas nenit 8 të LMT-së i aplikueshëm në rastin konkret, të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat përbëjnë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullar i markës tregtare mund t'i ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjë identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme. Me regjistrimin e një marke të caktuar, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare.

Bartësi i markës së regjistruar tregtare gëzon një numër të drejtash me regjistrimin e markës tregtare. Sipas LMT, bartësi i markës së regjistruar tregtare ka drejta të: ndalojë përdorimin e paautorizuar të markës tregtare të tij përmes mjeteve juridike në dispozicion (Nenet 8 – 13 i LMT); të përdorë markën e regjistruar në tregun e Kosovës (Neni 14 i LMT), si dhe të disponojë me markën tregtare të tij (Nenet 15 – 22 i LMT).

Mbajtësi i një marke tregtare sipas Nenit 8 të LMT-së, ka të drejtë të ndalojë: vendosjen e markës së mbrojtur, në mallra, në paketim ose etiketat e mallit; ofrimin e mallrave, vendosjen e tij në treg apo ruajtjen e saj për këto qëllime, apo ofrimin e shërbimeve nën markën tregtare të tij; importimin, eksportimin ose transitin e mallrave nën markën tregtare dhe përdorimin e markës së mbrojtur në dokumentet zyrtare ose për reklama.

Përdorimi i paautorizuar i një marke tregtare, si e drejtë ekskluzive e pronarit të saj, përbën shkelje të markës tregtare. Sipas Nenit 8 të LMT-së, shkelja mund të bëhet me çdo veprim të ndërmarrë pa autorizimin e pronarit, me të cilin atakohet të paktën njëri prej të drejtave të pronarit të markës tregtare. Kjo shkelje mund të bëhet gjatë kohës së vlefshmërisë së markës tregtare, brenda territorit për të cilën ajo është e autorizuar.

Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës rezulton si jokontestues fakti se i padituri me datë 25.02.2022 dhe 28.02.2022 ka importuar mallrat kontestuese pa autorizimin e paditësve, si bartës të së drejtave nga markat tregtare të regjistruara “COCA-COLA” dhe “Fanta” dhe “Sprite”. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, fakti se mallrat janë origjinale ose jo, nuk përbën fakt relevant për vlerësimin e shkeljes së markës tregtare. Bazuar në dispozitat e sipërcituara vetëm fakti i

importimit dhe vendosjes në treg të mallrave në tregun përkatës, pa autorizimin e bartësve të së drejtës së markave tregtare të regjistruara, përbën shkelje të markës tregtare.

Gjykata e vlerëson si të pabazuar pretendimin e të paditurit se në rastin konkret importimi i mallrave kontestuese nuk përbën shkelje të markave tregtare të paditësve, meqenëse të njëjtat janë origjinale dhe se shitja e tyre është e lejuar sipas importit paralel, pasi që ezaurimin (humbja) e të drejtave të markës tregtare (exhaustion of rights principle) – Doktrina apo parimi i “shterjes së të drejtave” pas “shitjes së parë” përbën parim sipas të cilit kontrolli i bartësit të markës tregtare mbi produktin apo shërbimin që bartë markën e tij tregtare pushon pas shitjes së parë të produktit. Ky parim i referohet kontrollit mbi produktin dhe jo kontrollin mbi markën tregtare si pronë e paprekshme. Kjo ndërlidhet me faktin se, një ndër të drejtat kryesore të bartësit të një marke tregtare është përdorimi i asaj marke në produktet e caktuara dhe që, ndër të tjera, nënkupton edhe hedhjen e produktit që mban atë markë në tregun e caktuar. Pra, hedhja e produktit në një treg të caktuar mund të bëhet vetëm nga bartësi i markës apo me pëlqimin e tij.

Shtete të ndryshme aplikojnë rregulla të ndryshme sa i përket parimit të “shterjes së të drejtave”. Disa shtete kanë aplikuar parimin e ezaurimit ndërkombëtar, që nënkupton se kontrolli i bartësit të markës tregtare mbi produktin pushon kur ky produkt të vendoset në tregun e cilitdo shtet në botë. Disa shtete aplikojnë parimin e ezaurimit regjional, ndërsa një numër i tyre aplikojnë parimin e ezaurimit nacional. Si rrjedhojë e kësaj mos harmonie midis shteteve të ndryshme, Marrëveshja TRIPS nuk ka adoptuar një politikë apo rregull sa i përket ezaurimit. Sipas nenit 6 të TRIPS, secili shtet anëtar është i lirë që të adoptojë ezaurimin ndërkombëtar, regjional ose nacional përderisa nuk janë në kundërshtim me dy parimet tjera të TRIPS, përkatësisht parimin e trajtimit kombëtar dhe parimin e trajtimit më të favorshëm. Direktiva e BE-së [Direktiva e Parë e Këshillit 89/104/EEC (1988)] –, shumë qartë e përcakton parimin e ezaurimit regjional. Kjo nënkupton se bartësi i markës tregtare humb të drejtën të kontrollojë qarkullimin e produktit i cili e bartë markën e tij tregtare në momentin e vendosjes së këtij produkti në tregun e cilitdo shtet të Bashkimit Evropian.

Megjithatë, sikurse edhe shumica e shteteve të Bashkimit Evropian, LMT i Kosovës aplikon parimin e ezaurimit nacional derisa Republika e Kosovës të anëtarësohet në Bashkimin Evropian (neni 12, paragrafi 1 i LMT të aplikueshëm në rastin konkret). Pra, sipas kësaj të drejtë e bartësit të markës së regjistruar për të kontrolluar qarkullimin e mallrave apo shërbimeve do të pushojë vetëm kur këto mallra apo shërbime janë futur në tregun e Kosovës nga pronari apo me pëlqimin e tij. Për pasojë, në rast të importit paralel apo vendosjes së produkteve të caktuara (autentike)

në tregun e Kosovës, pa lejen e bartësit, i njëjti mund të kërkojë nga gjykata të ndalojë një veprim të tillë meqë ky veprim paraqet shkelje të markës tregtare të mbrojtur.

Neni 12 i LMT-së, përcakton qartë se: *“humbja e të drejtës për ndalimin e përdorimit të markës për produkte dhe shërbime fillon me futjen e markës në tregun e Republikës së Kosovës nga ana e vet pronarit ose pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, në ndonjërin nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian apo shteteve që janë palë në Marrëveshjen që krijon Zonën Ekonomike Evropiane, me atë markë tregtare”* çka nënkupton se shtetja e së drejtës sipas shitjes së parë bëhet vetëm në rastet kur bartësi i të drejtës së markës tregtare e shet vet atë produkt apo përmes të autorizuarit të tij, në territorin e Republikës së Kosovës, por kjo e drejtë nuk konsumohet nëse produkti është shitur jashtë Republikës së Kosovës, si në rastin konkret.

Duke u nisur nga të lart cekurat, Gjkata ka gjetur se i padituri me importimin e mallrave kontestuese dhe vënien e tyre në treg, pa autorizimin e bartësit të markës tregtare të regjistruar, ka shkelur markat tregtare të paditësve andaj gjykata vendosi që të aprovoj pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të vërtetoj se i padituri me rastin e importimit të produkteve “Coca-Cola”, “Fanta” dhe “Sprite” me datat 25.02.2022 dhe 28.02.2022 ka shkelur markat tregtare të paditësit nr. 2982, 2980 dhe 5901 të regjistruara pranë API-së. Për shkak të shkeljes së konstatuar gjykata në kuptim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit nr. 05/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Markat Tregtare, i ka ndaluar të paditurit shkeljen e të drejtave të paditësit, ka urdhëruar shkatërrimin e mallrave si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi si dhe ka obliguar të paditurin që të mbuloj të gjitha shpenzimet për shkatërrimin dhe shpenzimet e magazinimit të mallrave, ndërsa në kuptim të nenit 99 të LMT-së ka obliguar të paditurin që me shpenzimet e tij të publikoj këtë aktgjykim në tri medime të Kosovës.

Gjkata refuzoi pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit me të cilën ka kërkuar që të urdhërohet Dogana e Kosovës dhe Inspektorati i Tregut që të konfiskohen dhe shkatërrohen të gjitha produktet e ndodhura kundërligjshëm në territorin e Republikës së Kosovës pa autorizimin dhe / apo pëlqimin e paditësit pasi që gjykata vlerëson se një kërkesë e tillë është jashtë objektit të shqyrtimit të shkeljes së markës tregtare sipas rasteve të iniciuara nga Dogana e Kosovës sipas Njoftimit nga Dogana e Kosovës- Rasti 83-2022 Coca –Cola dhe Njoftimit nga Dogana e Kosovës- Rasti 84-2022 Coca –Cola, ndërsa kërkesa e paditësit për konfiskim dhe shkatërrim të gjitha produkteve të ndodhura kundërligjshëm në Republikën e Kosovës përbën kërkesë të papërcaktuar në mënyrë të saktë, rrjedhimisht edhe të parealizueshme.

Për arsyet e njëjta gjykata po ashtu ka refuzuar kërkesën e paditësit që të Urdhërohet i padituri "Dea IB" SH.P.K. që ti ofroj paditësit në dispozicion Deklaratat Unike Doganore për produktet e importuara pa autorizimin dhe / apo pëlqimin e bartësit të së drejtës së markës tregtare për 3 vitet e fundit duke filluar nga data e nxjerrjes së vendimit gjyqësor.

Ndërsa lidhur me kërkesën për kompensimin e dëmit material gjykata me Aktvendimin e datës 01.10.2024 ka refuzuar propozimin e paditësit për nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare për shkak se mallrat kontestues të ndalur nga dogana me datat 25.02.2022 dhe 28.02.2022, me masë të sigurisë të caktuar nga gjykata dhe vërtetuar nga shkalla e dytë të njëjtat janë konfiskuar dhe janë ndaluar për qarkullim të lirë në treg të gjitha produktet të importuara nga i padituri, ndërsa llogaritja e fitimit në humbur sikurse këto mallra do të dilnin në treg të lirë do të përbënte vlerësim hipotetik, andaj gjykata të njëjtën propozim e refuzoi si të pabazuar. Gjithashtu gjykata ka refuzuar propozimin e paditësit që të bëhet kalkulimi i dëmit të pretenduar për tre vitet paraprake pasi që gjykata gjeti se në këtë çështje kontestimore objekt i kontestit është shkelja e pretenduar për datat 25.02.2022 dhe 28.02.2022 andaj refuzoi propozimin për nxjerrjen e provës me ekspertizës financiare për periudhë e cila është jashtë objektit të shqyrtimit të padisë.

Andaj, duke qenë se me Aktvendimin IV.EK.nr. 128/22 të datës 04.04.2022 është aprovuar propozimi i paditësit për caktimin e masës së sigurisë dhe për mallrat e përcaktuar si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimit është urdhëruar Dogana e Kosovës që ti ndaloj, konfiskoj dhe mos ti liroj për qarkullim të lirë në tregun e Republikës së Kosovës, gjykata vlerëson se në këtë rast është parandaluar shkaktimi i dëmit tek paditësi pasi që këto mallra nuk janë futur në qarkullim të lirë në tregun e Republikës së Kosovës rrjedhimisht nuk ka ndikuar në zvogëlimin e fitimit për paditësin. Për këto arsye gjykata refuzoi kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e dëmit material në formën e fitimit të humbur.

Pasi që gjykata ka konstatuar se i padituri ka shkelur markat tregtare të paditësit, gjykata në pikën VI të dispozitivit la në fuqi masën e sigurisë të caktuar me Aktvendimin IV.EK.nr. 128/22 të datës 04.04.2022 deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet gjyqësore si në pikën VIII të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, gjykata vendosi sipas nenit 452 par.1 dhe 2 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e arritur në procedurën gjyqësore, ashtu që paditësit ia njohu shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të përpilimit të padisë në shumën prej 208€, për tri seanca të mbajtura nga 270€ (25.03.2022, 01.10.2024 dhe 04.12.2024) shumën prej 810€, ndërsa në përputhje me tarifën e OAK duke

zbatuar rritjen prej 100% për shkak të kontestit me element të huaj, gjykata i njohu paditësit shpenzimet për përpilim të padisë dhe përfaqësimit shumë prej 2,036€ dhe shumë prej 72€ në emër të taksës gjyqësore, apo shumë e përgjithshme prej 2,108€.

Nga të cekurat më lartë, gjykata bazuar në nenin 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.2381/22, datë 10.12.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.